

V E N D I M
Nr.8, datë.11.1994

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Feti Gjilani,	Zv/kryetar i	""
Hilmi Dakli,	Anëtar i	""
Manol Konomi,	Anëtar i	""
Franc Jakova,	Anëtar i	""
Veli Budo,	Anëtar i	""
Thimjo Kondi,	Anëtar i	""
Ylvi Myrtja,	Anëtar i	""
Natasha Sheshi,	Anëtare e	""

me sekretare Drita Filto, më datën 17.10.1994 dhe 3.11.1994, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.7 Akti, që i përket :

K Ë R K U E S : URIM BEJLERI, ish-gjyqtar në Gjykatën e rrethit Tiranë.

K U N D Ë R : KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, në mungesë.

O B J E K T I:

Deklarimi i pakushtetutshmërisë së vendimeve nr.10, datë 20.10.1993 dhe nr.12, datë 12.11.1993, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë të nenit 24, pika 9, të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Shtetasi Urim Bejleri, në kërkesën e tij datë 26.11.1993 dhe në shpjegimet që dha në gjyq pretendon se dy vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë të dhëna ndaj tij, si ai për transferimin nga gjyqtar i Gjykatës së Rrethit të Tiranës në kryetar të Gjykatës së Laçit edhe Vendimi i mëvonshëm për nxjerrjen në asistencë janë të pabazuara në ligj, janë arbitrare dhe përbëjnë shkelje të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Konkretisht, ndër të tjera, ai ka parashtruar se të dy vendimet janë marrë pa iu komunikuar më parë pretendimet që kanë organet kompetente shtetërore ndaj tij, pa iu dhënë mundësia për të dhënë shpjegime para Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pa u zhvilluar gjykimi në bazë të një procedure të rregullt të parashikuar në rregulloren përkatëse në bazë të së cilës duhet të funksionojë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, e pa iu dhënë mundësia të ankohet në ndonjë organ shtetëror kundër vendimeve të dhëna ndaj tij.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relacionin përkatës,

V E R E N :

Zoti Urim Bejleri, deri në marrjen e vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të kundërshtuara prej tij në këtë Gjykatë, ka punuar si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit të Tiranës. Më datën 21.10.1993, i është komunikuar verbalisht Vendimi datë 20.10.1993 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për transferimin e tij si kryetar në Gjykatën e Rrethit të Laçit. Kjo provohet edhe me shkresën nr.353/2, datë 3.3.1994 të Ministrisë së Drejtësisë bashkëngjitur me materialet e dosjes ku thuhet shprehimisht :

"Në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.10, datë 20.10.1993, në kuadrin e riorganizimit dhe të përmirësimit të funksioneve të organeve të drejtësisë, z. Urim Bejleri, është transferuar nga Gjykata e Tiranës në detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit të Laçit".

Për të kërkuar sqarime rreth vendimit të marrë në mungesë, z. Bejleri i është drejtuar Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, por nuk ka marrë përgjigje.

Më datën 25.11.1993 ka marrë dijeni për vendimin tjetër nr.12, datë 12.11.1993 me të cilin

urdhërohej kalimi i tij në asistencë.

Sa më lart provohet edhe me shkresën po me nr.353/2, datë 3.3.1994 të Ministrisë së Drejtësisë me këtë përmbytje : “Në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr.12, datë 12.11.1993, në kuadrin e riorganizimit dhe të përmirësimit të funksioneve të organeve të Drejtësisë, z. Urim Bejleri, meqënëse nuk është paraqitur në detyrën e kryetarit të Gjykatës së Rrethit të Laçit, kalon në asistencë”.

Për të pasur prova më të plota për gjykimin e kësaj çështjeje, Gjykata Kushtetuese ka kërkuar nga Ministria e Drejtësisë, që në bazë të nenit 20 paragrafi i fundit të ligjit nr.7574, datë 24.6.1992, si organ që i paraqet materialet përkatëse për gjyqtarët Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe nga vetë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, rregulloren e punës së Këshillit, procesverbalin e gjykimit të çështjes dhe vendimet e dhëna prej atij Këshilli, si dhe është kërkuar që një anëtar i Këshillit ose një përfaqësues i tij, të japë shpjegimet e nevojshme para kësaj Gjykate.

Duke qenë se Rregullorja e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nuk rezulton të jetë botuar për t’iu bërë e njohur masës së gjyqtarëve e prokurorëve, dhe as iu vu në dispozicion Gjykatës Kushtetuese, me gjithë insistimin e saj, kjo Gjykatë krijon bindjen se Këshilli i Lartë i Drejtësisë e ka gjykuar çështjen pa pasur rregulloren përkatëse. Kjo bie në kundërshtim me nenin 10 të ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 të vënë në mbrojtje të gjyqtarëve, sipas të cilit,

“Gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit kanë imunitet dhe nuk mund të lëvizin nga detyra gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Heqja e imunitetit dhe lëvizja e tyre mund të bëhet vetëm nga organi kompetent në rastet dhe sipas procedurës së caktuar me ligj”.

Rastet e largimit nga puna të gjyqtarëve parashikohen në nenin 19 të ligjit nr.7574, datë 24.6.1992. Ndër to nuk përfshihet “riorganizimi e përmirësimi i funksioneve të organeve të drejtësisë”. Gjithashtu, nga materialet e çështjes nuk rezulton që zoti Urim Bejleri të ketë kryer ndonjë shkelje disiplinore, por, edhe sikur të pranohej ekzistenca e një shkeljeje të tillë, atëherë Këshilli i Lartë i Drejtësisë, do të kishte të drejtë të merrte njërën nga masat disiplinore të parashikuara në nenin 20 të këtij ligji. As në këtë nen, as në ndonjë dispozitë tjetër ligjore, që ka të bëjë me statusin dhe garancitë e gjyqtarit, nuk përfshihet një masë e tillë.

Duke qenë se gjyqtari Urim Bejleri është transferuar pa i marrë pëlqimin dhe më vonë është hequr nga detyra, në të dy rastet pa një shkak të parashikuar në dispozitat kushtetuese ose në dispozita të tjera ligjore të nxjerra në pajtim me ato kushtetuese, arrijmë në përfundimin se në rastin konkret është shkelur parimi kushtetues i patundshmërisë së gjyqtarëve gjatë mandatit përkatës të ushtrimit të detyrës së tyre.

Si rrjedhim është cenuar edhe parimi tjetër kushtetues i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, mbasi gjyqtari mbetet kështu pa iu garantuar mbrojtje përkatëse.

Gjithashtu, nga shqyrtimi në tërësi i çështjes, rezultojnë të provuara pretendimet e kërkuarit, sipas të cilave, atij as i është bërë e ditur më parë se përse do të gjykohej, as është thirrur e as ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes së tij, domethënë, nuk i është dhënë mundësia për të dhënë shpjegime e për t’iu dëgjuar arsyet që mund të parashtronte.

Gjithashtu atij nuk i është dhënë ndonjë vendim i arsyetuar në fakte e në ligj, si dhe mundësia për t’u ankuar në një organ kompetent shtetëror.

Për të arritur në përfundime të plota e objektive Gjykata Kushtetuese insistoi në kërkimin e procesverbalit të gjykimit të shqyrtimit të çështjes, por fakti që ky procesverbal nuk u paraqit, të çon në përfundimin që ky procesverbal ose nuk është i rregullt, ose nuk është mbajtur fare. I pajustificueshëm e i papajtuueshëm me standardet e një shteti juridik është edhe refuzimi për të dërguar në gjyq një përfaqësues të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të dhënë shpjegimet e nevojshme rreth procedurës së ndjekur për gjykimin e kësaj çështjeje.

Duke u nisur nga të dhënat për mënyrën e gjykimit të çështjes së gjyqtarit Urim Bejleri, nga fakti i mungesës së një rregulloreje të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të miratuar e të botuar rregullisht, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se në rastin konkret është shkelur edhe e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 38 të ligjit kushtetues “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut” nr.7692, datë 31.3.1993. Kur dispozita kushtetuese e lartpërmendur, parashikon se “Liria, prona ose të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor”, ajo nuk ka parasysh vetëm qytetarët e thjeshtë, por edhe ata që gjykojnë të tjerët, dmth, gjyqtarët. Gjyqtarët kanë një status të përcaktuar në dispozita kushtetuese, në ligjin mbi organizimin gjyqësor, si dhe në dispozita të akteve ndërkombëtare të gjithëpranuara në shtetet demokratike e juridike. Të

drejtat që ata gëzojnë në bazë të dispozitave të lartpërmendura, nuk mund të preken, veçse në rastet e parashikuara shprehimisht në këto dispozita dhe sipas procedurave të pranuara po në to.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 24 pika 9 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Të shpallë antikushtetues vendimin nr.10, datë 20.10.1993 dhe nr.12, datë 12.11.1993, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Votuan pro këtij vendimi: Feti Gjilani, Manol Konomi, Hilmi Dakli, Veli Budo, Franc Jakova, Thimjo Kondi, Natasha Shehi, Ylvi Myrtja. Votoi kundër Rustem Gjata.

MENDIMI I PAKICËS

Nuk jam dakord me vendimin e dhënë nga shumica për këto arsye :

Në bazë të nenit 10 paragrafi i dytë të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, lëvizja e gjyqtarëve (të shkallës së parë dhe të apelit) mund të bëhet vetëm nga organi kompetent, në rastet dhe sipas procedurës së caktuar me ligj. Në nenin 15 paragrafi i dytë të po këtij ligji, Këshilli i Lartë i Drejtësisë është përcaktuar si i vetmi organ i autorizuar për të vendosur për emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve.

Të dyja këto dispozita kushtetuese duhej të kiheshin parasysht nga shumica për të arritur në një përfundim të drejtë e të bazuar lidhur me kompetencat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe bazueshmërinë e vendimit të tij nr.10, datë 20.10.1993.

Në vendimin e saj shumica i është shmangur krejtësisht dispozitës së nenit 15 të ligjit kushtetues të sipërpërmendur. Për më tepër ajo i është referuar pa vend edhe neneve 19 e 20 të ligjit nr.7574, datë 24.6.1992 “Për organizimin e Drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e procedurave penale e civile”, pasi kërkuesi me vendimin nr.10, datë 20.10.1993, nuk është larguar nga detyra dhe as është marrë ndaj tij masë disiplinore. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka vendosur lëvizjen e tij nga një gjykatë rrethi, duke e caktuar drejtues në një gjykatë të një rrethi tjetër. Kjo lëvizje, për mendimin tim, në themel është në pajtim të plotë me nenin 15 paragrafi i dytë të ligjit kushtetues. Ndryshimi i bërë në ndarjen administrative - tokësore, ka sjellë si pasojë edhe nevojën e krijimit të gjykatave të reja në rrethet e sapokrijuara. Ky riorganizim, kuptohet, e ka bërë të domosdoshme edhe plotësimin e gjykatave të sapokrijuara me drejtues dhe gjyqtarë. Nga dokumentet e administruara ka rezultuar se shkaku dhe qëllimi i lëvizjes së kërkuesit ka qenë pikërisht riorganizimi i gjykatave të rretheve, duke u krijuar disa gjykata të reja. Ky është një shkak objektiv, i cili si përjashtim i jepte të drejtë Këshillit të Lartë të Drejtësisë të bënte lëvizjen e gjyqtarëve për një kohë të caktuar edhe pa pëlqimin e tyre.

Por, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke mos e thirrur dhe dëgjuar paraprakisht kërkuesin lidhur me pretendimet dhe mundësitë e tij, ka vepruar në kundërshtim me nenin 38 të ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Çdo organ është i detyruar të zbatojë një proces të rregullt ligjor gjatë ushtrimit të detyrave të veta kushtetuese, që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut të njohura me ligj.

K R Y E T A R I
Rustem Gjata

ARSYETIM PARALEL

Në arsyetimin e vendimit shumica ka dalë jashtë caqeve të çështjeve të shtruara dhe të marra në shqyrtim nga Gjykata.

Në vendimin (në pjesën arsyetuese) duhet të pasqyrohen vetëm ato probleme, ligjore ose fakti, që janë ngritur dhe diskutuar, ndërsa në vendimin e përgatitur nga shumica bëhet fjalë për shkëljen e parimit kushtetues të pavarësisë së gjykatave, për parimin e patundshmërisë së gjyqtarëve, për mungesën e një vendimi të arsyetuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për mosnjohjen e mundësisë për t'u ankuar në një organ tjetër. Kjo përbën një shkelje të rëndë të parimeve më elementare të drejtësisë.

Gjatë shqyrtimit dhe përpara votimit, Gjykata arriti në konkluzion se transferimi i gjyqtarit Urim Bejleri, për arsye disiplinore ose për çdo arsye tjetër, është bërë duke shkelur si nenin 38 të ligjit "Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut", që parashikon zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, ashtu dhe të nenit 11 të këtij ligji, sipas të cilit "Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për t'u dëgjuar para se të dënohet", natyrisht kur është rasti për marrjen e masave disiplinore.

Thirrja për t'u mbrojtur ose për të dhënë shpjegime para se të merret një masë ndaj një personi, është një nga parametrat e pakontestueshme, esenciale dhe të njohura të një procesi të rregullt ligjor dhe në rastin e nenit 11 një kusht sine que non përpara se të merret një dënim (masë disiplinore).

Mungesa e Rregullores për funksionimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nuk e legjitimon dhe nuk e përjashton atë nga detyrimi që të thërrasë personin e interesuar për t'u mbrojtur dhe për të dhënë shpjegime.

Për këtë arsye dhe vetëm për këtë u vendos që të shpallet Vendimi nr.10, datë 20.10.1993 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë si antikushtetues.

A N Ë T A R
Hilmi Dakli

A N Ë T A R
Manol Konomi

ARSYETIMI PARALEL

Sipas paragrafit të dytë të nenit 15 të ligjit kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992 "Këshilli i Lartë i Drejtësisë është i vetmi autoritet që vendos për emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të shkallës së parë, të apelit si edhe të prokurorëve".

Por, nga kjo në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohet që Këshilli i Lartë i Drejtësisë të ketë të drejtë t'i lëvizë gjyqtarët paralel në gjykata të rretheve të tjera, qoftë edhe duke i ngritur në përgjegjësi (duke përfshirë këtu edhe ngritjen në përgjegjësi po në atë rreth), në kundërshtim me dëshirën e tyre, pa qenë fare nevoja të paraqesin shkaqet e mospranimit.

Sepse një veprim i tillë vjen në kundërshtim me parimin e patundshmërisë së gjyqtarëve, të fiksuar në nenin 10 të po këtij ligji kushtetues, në paragrafin e parë të të cilit thuhet se "gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit kanë imunitet dhe nuk mund të lëvizin nga detyra gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre".

Nisur nga kjo bazë ligjore, nuk mund të trajtohet si shkelje e disiplinës në punë refuzimi i gjyqtarit për të lëvizur në një gjykatë të një rrethi tjetër, qoftë edhe me ngritje në përgjegjësi si kryetar gjykate.

Edhe në aspektin logjik nuk mund të pranohet që pasi një gjyqtar ngrihet në përgjegjësi si kryetar gjykate (pra, presupozohet se i ka meritat edhe për këtë detyrë më të lartë), të shkarkohet edhe nga detyra që kishte si gjyqtar i thjeshtë vetëm për faktin se nuk pranon të marrë detyrën më të lartë.

Një arsyetim i tillë i vendimit do të ishte i mjaftueshëm për të arritur në konkluzionin që ka arritur Gjykata në pjesën urdhëruese, pa qenë nevoja të shprehet në pjesën arsyetuese se çfarë dokumentesh ka kërkuar Gjykata nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, insistimi i saj për kërkimin e procesverbalit të gjykimit të kësaj çështje, të Rregullores për funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për thirrjen e përfaqësuesve të këtyre organeve në gjyq etj, të cilat janë veprime procedurale.

Gjithashtu, është i tepërt paragrafi i fundit i pjesës arsyetuese të vendimit ku flitet për shkëljen e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 38 të ligjit nr.7692, datë

31.3.1993 “Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut” për faktin se kërkuesi nuk është thirrur për t’u dëgjuar para Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Sepse asnjë thirrje e kërkuesit për t’u dëgjuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk do ta justifikonte këtë të fundit ta largonte kërkuesin nga detyra e gjyqtarit në kundërshtim me parimin e sanksionuar në nenin 10 të ligjit Kushtetues nr.7561, datë 29.4.1992, siç u përshkrua më sipër.

A N Ë T A R
Franc Jakova

Tiranë, më 3.11.1994